



KLUBI I FUTBOLLIT VLLAZNIA

Nr. 314 prot.

Shkoder, 26 Korrik 2021

Drejtuar: Znj. Ogerta Manastirliu
Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Për Dijeni: Znj. Evis Kushi
Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Lënda: Mbi lejimin e spektatorëve në ndeshjen e kthimit të turit të dytë Vllaznia - AEL e vlefshme për kompeticionin e Liga Konferencës Evropiane (Europe Conference League)

E nderuar znj. Ministre,

Në kuadër të turit të dytë të kompeticionit të Liges së Konferencës Evropiane me datën 29 Korrik 2021 në orën 21.00 në stadiumin Loro Borici në Shkodër zhvillohet takimi i kthimit me skuadrën Qipriote të AEL Limassol. Takimi i parë i zhvilluar me datën 22 Korrik ka përfunduar 1-0 në favorin e skuadrës AEL Limassol.

Duke qënë se ndeshja e kthimit e planifikuar me datën 29 Korrik 2021 ka një interes të jashtzakonshëm nga qytetarët shkodranë të cilët futbollin e kanë si aktivitetin e tyre parësorë në jetën e përditshme pritet një numër i konsiderueshëm spektatorësh në tribunat e stadiumit Loro Borici.

Për Klubin e Futbollit Vllaznia shëndeti i lojtarëve, stafeve teknike dhe spektatorëve do të mbetet prioritare dhe në këtë frymë kemi prezantuar edhe në ndeshjen e zhvilluar në Shkodër me datën 15 Korrik 2021 kundër boshnjakve të Siroki Brijeg ku falë zbatimit rigoroz të rregullave dhe protokolleve ndeshja u ndoq nga rreth 5000 tifozë shkodranë pa asnjë lloj problemi shëndetsorë si gjatë zhvillimit por edhe pas mbarimit të saj.

Duke kërkuar mirëkuptimin dhe bashkpunimin tuaj ne do tju luteshim që në ndeshjen e datës 29 Korrik në orën 21.00 në stadiumin Loro Borici të lejohet prania e tifozëve pa asnjë kufizim duke konsideruar se qyteti i Shkodrës prej kohësh ka arritur tashmë një imunizim falë edhe masave të kujdesshme të ndërmarra dhe ecurisë mjaft të mirë të procesit të vaksinimit masiv të popullatës nga ana e MSHMS.

Shprehim bindjen se ky vendim do të ndihmonte në rikthimin e normalitetit në sport dhe në jetën sociale të qytetit të Shkodrës dhe do të ishte edhe një shembull suksesi në të gjithë vendin sesi mund të garantohet siguria publike duke iu rikthyer aktiviteteve të këtyre përmasave.

Duke ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin, mbetemi në pritje të një përgjigje pozitive nga ana Juaj.



Me konsiderate

Voltana ADEMI

Kryetare e Bashkise Shkoder